

ABSTRAKT

PAVLEFSHMËRIA E KONTRATAVE NOTERIALE

Vlefshmëria është pjesa qenësore në lidhjen e kontratave pasi që moslidhja e tyre sipas dispozitave ligjore, lë hapësirë që kontrata të jetë e pavlefshme. Gjatë viteve të fundit në Kosovë, noteria ka pasur një zhvillim të madh, kjo duke pasur parasysh zhvillimin ekonomik - shoqëror në vendin tonë dhe vëmendja që i është kushtuar lidhjes së kontratave sipas rregullave të parapara me ligjet përkatëse. Mirëpo, përveç rëndësisë që ka noterizimi i kontratave të ndryshme, rëndësi të veçantë duhet kushtuar pavlefshmërisë së kontratave noteriale, duke pasur parasysh se mospërpilimi i kontratave në mënyrën e duhur e në mospërputhshmëri me rregullat ligjore, shkakton pavlefshmëri të kontratave noteriale. Pavlefshmëria përfshinë shumë aspekte të së drejtës në përgjithësi, çka do të thotë se lehtësisht mund të cenohen interesat e palëve kontraktuese apo edhe të personave të tretë. Andaj, ky punim ka për qëllim studimin e pavlefshmërisë së kontratave noteriale si një pjesë e rëndësishme e lidhjes së kontratave dhe sistemit noterial në përgjithësi e po ashtu informimin më të gjerë sa i përket nocionit të pavlefshmërisë, llojet e pavlefshmërisë, pasojat e pavlefshmërisë dhe në përgjithësi rëndësisë që ka pavlefshmëria e kontratave noteriale.

Mentori:

Prof.Ass.Dr. Bashkim Preteni

Kandidatja:

Zamirë Krasniqi